



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE  
DREJTORIA TEKNIKE

Sektori i Taksave, Tatimeve Direkte, Kontributeve dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare

Nr. 14919 Prot.

Tiranë, më 28.12/2014

**Lënda: Udhëzues teknik për zbatimin e nenit 35 të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar**

**Drejtuar: DREJTORISË RAJONALE TATIMEVE**

**Për dijeni: Zv/Drejtorët e Përgjithshëm**  
**Drejtoria Ligjore**  
**Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit**  
**Drejtoria e Apelimit Tatimor**  
**Drejtoria e Hetimit Tatimor**  
**Drejtoria e Kontrollit Tatimor**  
**Drejtoria e Auditit të Brendshëm**  
**Drejtoria e Investigimit të Brendshëm ( Antikorrupsioni)**  
**Drejtoria e Shërbimit dhe Regjistrimit të Tatimpaguesve**  
**Drejtoria e Menaxhimit të Riskut**  
**Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit**  
**Avokati i Tatimpaguesve**

**KËTU**

Për zbatimin korrekt të nenit 35 “Mbajtja e tatimit në burim, regjistrimi, deklarimi dhe pagesa” ë Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, të gjithë atimpaguesit, të cilët janë të detyruar të llogarisin, mbajnë, deklarojnë dhe paguajnë për llogari ë administratës tatimore, tatimin në burim në masën 10% nga shuma bruto e pagesave të përcaktuara në nenin 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat” të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, duhet të njoftohen që:

1. Pagesa e detyrimeve që kanë të bëjnë me çdo tatim të mbajtur në burim gjatë një muaji, do të vazhdoj të bëhet në bankat e nivelit të dytë, në të njëjtin afat (brenda datës 20 të muajit pasardhës) dhe në të njëjtën mënyrë si edhe më parë. Pra lidhur me këtë, aktualisht nuk do të ketë asnjë ndryshim, pavarësisht ndryshimeve të fundit ligjore.

2. Përveç sa më sipër, të gjithë tatimpaguesit e mësipërm, bazuar në nenin 35 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar kanë detyrimin të paraqesin “Formularin e deklarimit dhe pagesës së tatimit në burim” në Drejtorinë Rajonale Tatimeve të rrethit përkatës. Ky formular nuk dërgohet në bankë, por vetëm në Drejtorinë Rajonale Tatimeve, ku tatimpaguesi është i regjistruar, nëpërmjet postës rekomande. Drejtoria Rajonale Tatimore depoziton formularin në dosjen e tatimpaguesit.

“Formulari i Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit në Burim” merret nga faqja zyrtare e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe plotësohet në mënyrë manuale.

3. Kjo mënyrë e deklarimit dhe e pagesës së tatimit në burim do të vazhdoj deri në tetor të këtij viti, kur sistemi i ri tatimor të vihet në punë. Me vënien në punë të sistemit të ri, edhe deklarimi i tatimit të mbajtur në burim do të bëhet në rrugë elektronike sipas formularit të ri.

Për sa është udhëzuar më sipër, Drejtorët e Drejtorive Rajonale Tatimore të marrin masa të menjëhershme organizative për shpërndarjen dhe njohjen me përmbajtjen e shkresës për punonjësit e administratës tatimore në varësi, si dhe sqarimin e tatimpaguesve lidhur me mënyrën e deklarimit dhe pagesës të tatimit në burim.

Në zbatim të nenit 28 “Informimi i publikut” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ky udhëzues gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al)

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**BRISIDA SHEHAJ**

